

LIGJ
Nr.7616, datë 30.9.1992

**PËR MIRATIMIN ME NDRYSHIME TË DEKRETIT NR.266, DATË 22.7.1992 "PËR
MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË"**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 28 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese",

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Të miratojë me ndryshime dekretin nr.266, datë 22.7.1992 "Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë".

Neni 2

Dekretit t'i bëhen ndryshimet në nenet përkatëse si më poshtë:

Neni 1, të formulohet: "Buxheti i shtetit është programi kryesor financiar. Pjesët formuese të tij janë: buxheti kombëtar, buxhetet lokale, buxheti i sigurimeve shoqërore shtetërore dhe i përkrahjes sociale".

Neni 3, të bashkohet me nenin 10 dhe të formulohet:

"Buxheti kombëtar përfshin të ardhurat, që me ligj derdhen në buxhetin e shtetit dhe shpenzimet për arsimin, shëndetësinë, kulturën, shkencën, sportet, sigurimet shoqërore shtetërore, përkrahjen sociale, mbrojtjen dhe rendin publik, shpenzimet për investime, për mbajtjen e aparatit shtetëror dhe shpenzime të tjera që përcaktohen me ligj.

Buxhetet lokale përfshijnë të ardhurat, që me ligj u lihen atyre dhe shpenzimet për mbajtjen e administratës shtetërore lokale, shpenzimet social kulturore, investimet dhe shpenzime të tjera, që caktohen me ligj".

Neni 4, të formulohet: "Buxheti i shtetit hartohet, miratohet dhe zbatohet me ligj. Ai si rregull është vjetor dhe përkon me vitin kalendarik, që fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor".

Neni 12, të formulohet: "Buxheti i shtetit hartohet nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë, në bazë të objektivave ekonomiko-financiare të vendosura nga Kuvendi Popullor dhe Këshilli i Ministrave. Për realizimin e kësaj të gjitha njësitë ekonomike, institucionet qendrore dhe lokale janë të detyruara të paraqesin sipas shkallës së vartësisë treguesit ekonomikë e financiarë dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm".

Neni 13, të bashkohet me nenet 16 dhe 19 dhe të formulohet: "Të gjitha ministrinë, institucionet qendrore dhe organet e administratës lokale, detyrohen të paraqesin në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë brenda datës 15 shtator të çdo viti projektbuxhetin e tyre për vitin e ardhshëm buxhetor.

Ministria e Financave dhe ekonomisë paraqet në Këshillin e Ministrave, brenda datës 15 tetor të çdo viti, kufijtë maksimalë të shpenzimeve shtetërore dhe të ardhurat e buxhetit të shtetit si dhe objektivat e politikës fiskale për vitin e ardhshëm buxhetor.

Këshilli i Ministrave pasi i miraton ato ia paraqet Kuvendit Popullor jo më vonë se fundi i muajit tetor.

Pas miratimit të objektivave të politikës fiskale nga Kuvendi Popullor, Këshilli i Ministrave i paraqet atij për shqyrtim e miratimi projektligjin e buxhetit të shtetit jo më vonë se 20 nëntori i çdo viti".

Në nenin 15, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika "d" të formulohet: "Propozimet për rritjen e mundëshme të të ardhurave buxhetore dhe

shkurtimin e shpenzimeve".

2. Pika "e", të bashkohet me pikën "ë" e të formulohet:

"Tepricën e gjendjes së të ardhurave buxhetore të disponueshme në fund të vitit të kaluar, të vitit në vazhdim dhe të vitit për të cilin paraqitet buxheti".

3. Në pikën "gj", në rreshtin e tretë, në vend të presjes pas fjalës "...shtetit..." të vihet pikë dhe hiqen fjalët "...si dhe numrin e njerëzve që ka të drejtë të punësojë Qeveria".

Në nenin 18, në rreshtin e pestë, fjalët: "...sipas rastit..." të zëvendësohen me fjalët: "...sipas përkatësisë...".

Në nenin 22, në fillim të rreshtit të pestë, pas fjalës: "Ekonomisë", të hiqet presja e në vend të saj të vihet shkronja "e". Pas fjalëve "...të zgjedhura" të vihet pikë dhe të hiqen fjalët "...dhe të materialeve të institucioneve vartëse të organeve lokale", në fund të këtij neni.

Në nenin 23, në fund të rreshtit të tretë dhe të katërt, fjalët në fillim të fjalisë: "Miratimi përfundimtar..." të zëvendësohen me fjalën "Detajimi...".

Në nenin 24, të hiqet paragrafi i dytë sepse kjo detyrë është përfshirë në ligjin "Për Bankën e Shqipërisë".

Neni 26, të formulohet: "Ministria e Financave dhe e Ekonomisë ngarkohet me nxjerrjen e rregullave dhe të udhëzimeve për zbatimin e buxhetit të shtetit".

Në fund të nenit 28, të vihet presje në vend të pikës dhe të shtohen fjalët: "duke mbajtur në çdo rast ekuilibrin buxhetor".

Në nenin 29, pas presjes në fund të rreshtit të tretë të shtohen fjalët: "...nga Këshilli i Ministrave".

Neni 30, rreshti katër fjalët: "...mundësinë individuale të.." të zëvendësohen me fjalët "...mundësinë e...".

Neni 33, të formulohet: "Urdhëruesit e buxhetit organizojnë, mbikqyrin dhe kontrollojnë veprimtarinë financiare të njërive të tyre vartëse. Urdhëruesit kryesorë një herë në muaj duhet t'i raportojnë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë plotësimin e buxhetit të tyre. Kjo e fundit i raporton operativisht Këshillit të Ministrave për treguesit më kryesorë të plotësimit mujor të buxhetit të shtetit.

Shkelja e këtij rregulli përbën kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobë deri në 1000 lekë nga Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe punonjësit e autorizuar për administrimin e buxhetit nga urdhëruesit e fondeve sipas shkallëve. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e dhënies së tij, përkatësisht te ministri i Financave dhe Ekonomisë, ose te urdhëruesi i shkallës më të lartë akti i të cilit është i formës së prerë".

Neni 34, bashkohet me nenin 36 dhe formulohet: "Çdo fond buxhetor mund të përdoret vetëm për qëllimin e dhënë, me përjashtim të rasteve që me ligj vendoset ndryshe. Nuk lejohet që mjetet e buxhetit të shtetit të jepen hua, të përdoren për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë caktuar, të depozitohen në banka dhe institucione të tjera jashtë llogarive të buxhetit, që çelen për këtë qëllim në Bankën e Shqipërisë, ose të këmbehen me vlera të tjera.

Të gjitha tepricat e papërdorura të fondeve buxhetore, në fund të çdo viti buxhetor, kthehen dhe grumbullohen në llogaritë përkatëse të buxhetit të shtetit pranë Bankës së Shqipërisë në afatet që përcaktohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe".

Në nenin 35, në fillim të rreshtit të katërt të hiqen fjalët: "...qëllime dhe...".

Neni 37 të hiqet.

Neni 38, të formulohet: "Urdhëruesit kryesorë të kredive buxhetore me mbarimin e vitit buxhetor, në muajin shkurt të vitit pasardhës, paraqesin në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë raportin e plotë për zbatimin e buxhetit të vitit të kaluar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë nxjerr rezultatet e plota të zbatimit të buxhetit të shtetit për vitin e kaluar dhe së bashku me projektbuxhetin e vitit të ardhshëm i paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave në afatet e caktuara në nenin 13 të këtij ligji. Këshilli i Ministrave pasi shqyrton këto i përcjell për miratim në Kuvendin Popullor, brenda afateve të caktuara.

Buxhetet lokale faktike miratohen edhe nga organet e zgjedhura lokale në të njëjtën kohë me miratimin e projektbuxheteve të ardhshëm".

Në nenin 41, në rreshtin e shtatë fjalët në fillim të fjalisë "Brenda gjashtëmujorit të dytë të vitit

1992..". të zëvendësohen me fjalët: "Brenda muajit tetor të vitit 1992..".

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr.320, datë 13.10.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.